



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

| | |
|--|---|
| Drejtoria: | Drejtoria e Planifikimit Strategjik |
| Periudha raportuese: | Muaji korrik, 2023 |
| Emri dhe mbiemri i raportuesit: | Mimoza Sylejmani Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik |

PROJEKTET:

- Përditësimi i dokumentit të PZHK-së;
- Planifikimi i rrjetit rrugor të zonës rurale të Komunës së Prishtinës, për nevoja të hartimit të Hartës Zonale;
- Përpunimi i PRRU-ve dhe PPPH-ve, për nevoja të hartimit të Hartës Zonale;
- Përpunimi i file-ve të rrugëve të planifikuara, rr. "Muharrem Fejza" dhe rr. "Nekibe Kelmendi";
- Krijimi i file-ve, për projektin "Tulltorja";
- Përditësimi i rrugës "A, B dhe C" për nevoja të Hartës Zonale;
- Përditësimi i Unazës së qytetit, në bazë të projektit të fizibilitetit;
- Përditësimi i kërkesave të qytetarëve.

AKTIVITETET:

- Gjatë muajit korrik në Sektorin e planifikimit janë trajtuar gjithsej 36 lëndë;
- Informimi i palëve për kriteret e planeve, në ditët e caktuara me palë.

• **TAKIMET:**

- Takim pune me grupin punues, për hartimin e zgjidhjes urbane për Kampusin Sportiv, në lagjen
- “Zona Ekonomike” në Prishtinë;
- Takime të rregullta me kompaninë projektuese GM Architects, lidhur me definimin e hartimit të Master-Planit për rigjenerimin e lagjes “Kodra e Trimave 2”;
- Takim pune me grupin punues për hartimin e PRRH-së, të lagjes “Kalabria” në Prishtinë;
- Takim me përfaqësuesit e IFC-së, për caktimin e katër (4) lokacioneve për ndërtimin e katër shkollave fillore në Prishtinë;
- Takim për planin e mobilitetit;
- Takim për përditësimet e PZHK-së.

